

VENDIM
Nr.480, datë 29.06.2006

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË TV VENDOR “ANTENA JUG”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Halil	Lalaj	Kryetar
Sefedin	Çela	Anëtar
Albert	Minga	Anëtar
Visar	Zhiti	Anëtar
Agim	Duro	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi licencën e subjektit televiziv vendor TV Antena Jug.

SUBJEKT I INTERESUAR: TV Antena Jug, në mungesë.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, dhe vendimet nr.438, datë 21.3.2006 dhe nr.459, datë 11.5.2006 të KKRT-së,

VËREN:

Në datën 3.1.2006 ka përfunduar afati i licencimit të subjektit televiziv TV Antena Jug, të licencuar me vendimin nr. 29, datë 30.10.2000 të KKRT-së. Sipas licencës nr.034/TVL, zona e licencimit të këtij subjekti është pjesërisht rrethi Gjirokastrë.

KKRT ka njoftuar zyrtarisht këtë subjekt në datën 11.10.2005 me shkresën nr.770 prot., duke i caktuar datën 11 nëntor 2005 si afat për paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit për rinovimin e licencës. Nëpërmjet këtij njoftimi, KKRT i ka bërë të ditur subjektit TV Antena Jug, një sërë kriteresh që do të merren parasysh gjatë vlerësimit të kërkesave për rinovimin e licencave, në përputhje me pikën 4 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së. Kjo rregullore i është dërguar zyrtarisht subjektit me shkresën nr.770, datë 11.10.2005.

KKRT, me shkresën nr.770/2, datë 14.11.2005 ka rikujtuar subjektin për përfundimin e afatit të licencës, duke e shtyrë njëkohësisht afatin e depozitimit të dokumentacionit për rinovim licence deri në datën 5.12.2005.

Në mbarim të afatit të licencimit, duke qenë se subjekti nuk paraqiti dokumentacionin për rinovim licence, pra nuk shfaqti interes për rinovimin e licencës, në mbështetje të neneve 25, 33 pika 1 dhe 137/3, si dhe të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr.438, datë 21.3.2006 vendosi paraprakisht të mos i rinovojë licencën subjektit televiziv TV Antena Jug. Ky vendim i është përcjellë subjektit me shkresën nr. 213 prot, datë 23.3.2006.

Sipas pikës 1 të vendimit të mësipërm, subjektit iu la ka të drejtë që brenda një afati prej 30 ditësh të parashtrijë pretendimet e tij lidhur me këtë vendim. Nga ana e subjektit nuk u paraqit asnjë pretendim dhe as dokumentacion për rinovim licence, me gjithë komunikimin në mënyrë të herëpashershme, nëpërmjet shkresave zyrtare dhe me telefon.

Në mbledhjen e KKRT-së të datës 11.05.2006, për të cilën subjekti ishte njoftuar për pjesëmarrje për të dhënë pretendimet e tij para marrjes së vendimit përfundimtar, KKRT, pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të TV “Antena Jug”, vendosi me vendimin nr.459 të shtyjë afatin për depozitimin e dokumentacionit për rinovim licence për subjektin TV Antena Jug, duke caktuar datën 10 qershor 2006 si afat të fundit.

Subjekti është njoftuar për këtë vendim me shkresën nr.416, datë 15.05.2006 dhe megjithë kalimin e afatit nuk ka paraqitur asnjë pretendim dhe as dokumentacion për rinovim licence.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vëren se nga ana e subjektit nuk është respektuar ligji dhe aktet e miratuara nga KKRT.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të neneve 7 pika 21, 25, 33 pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, të vendimeve nr.438, datë 21.03.2006 dhe nr. 459, datë 11.05.2006 të KKRT-së, pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të TV “Antena Jug”,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca nr. 034/TVL dhënë shoqërisë “Antena Jug” sh.p.k. për TV “Antena Jug”.
2. Licenca, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti “Antena Jug” sh.p.k. është i detyruar ta ndërpresë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj